

**KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË, TË DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE, GRADAVE SHKENCORE DHE
TITUJVE AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË HUAJA TË
ARSIMIT TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË TJERA TË AUTORIZUARA**

1. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare, Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë kryhet *online* nëpërmjet portalit e-Albania.
2. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar duhet të depozitohet detyrimisht në formatin elektronik (PDF me ngjyra) gjatë aplikimit *online*.

Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “Doktor”, kryhet online sipas procedurës së mëposhtme:

- a. formulari i aplikimit plotësohet online në portalin e-Albania.
- b. aplikanti ngarkon në format elektronik dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vulë apostile ose legalizim nga vendi i lëshimit, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)
 - iv. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës online.

Pas njohjes dhe njësimit të diplomës, QSHA bën llogaritjen e mesatares së vlerësimeve të arritura brenda 5 ditëve pune. Njëvlershmëria e mesatares së vlerësimeve të arritura në shtetin përkatës kryhet për çdo vlerësim/notë që aplikuesi ka fituar sipas shtojcës së përcaktuar në udhëzim. Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në tabelë, të këtij udhëzimi, njëvlershmëria bëhet në bazë të informacioneve të marra në faqen e rrjetit ENIC-NARIC, ose agjenci dhe ente akredituese të IAL-ve të huaja.

3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:
 - a. formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;
 - b. aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) me ngjyra dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. diplomën dhe suplementin e saj (nëse ka të tillë), lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, që dëshmon fitimin e gradës shkencore “Doktor” ose dokumentin origjinal të

barasvlershëm me diplomën në rastet kur ky përbën dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën, **të pajisur me vulë apostile¹ ose legalizim nga vendi i lëshimit**, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

- ii. disertacionin e doktoratës. Në rast se disertacioni është në gjuhë të huaj, aplikanti paraqet një përmbledhje (reth 10 faqe) në gjuhën shqipe;
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
 - iv. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2.
- c. Aplikanti duhet të depozitojë një kopje të disertacionit përkatës në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë (BKSH) dhe të paraqesë vërtetimin përkatës.

Aplikimi për njohjen e titujve akademikë kryhet *online* sipas procedurës së mëposhtme:

- a. formulari i aplikimit plotësohet *online* në portalin e-Albania, sipas shtojcës nr. 1;
- b. aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) me ngjyra dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. dokumentin e fitimit të titullit akademik, **të pajisur me vulë apostile² ose legalizim nga vendi i lëshimit**, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;
 - ii. vërtetimin e regjistrimit të titullit akademik në bazën e të dhënave përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor të vendit ku është fituar titulli akademik (nëse ky regjistrim është parashikuar nga legjislacioni përkatës i huaj);
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit apo pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
 - iv. mandat-pagesën ose konfirmimin e pagesës *online*, sipas shtojcës nr. 2;
 - v. deklaratën/skedën e nënshkruar në të cilin të jepet informacion për eksperiencën akademike në mësimdhënie; aktivitetin shkencor – lista e artikujve/botimeve shkencore, pjesëmarrje në simpoziume, konferenca, kongrese shkencore të shoqëruar me titujt e materialeve të paraqitura; si dhe botime të punimeve shkencore në organe shkencore ndërkombëtare. Informacioni i parashikuar në këtë skedë duhet të shoqërohet me dokumentacionin provues përkatës.

¹ Vula apostile nuk vendoset në dokumentat e lëshuara nga vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dy palëshe për këtë çështje. Lista është e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

² Vula apostile nuk vendoset në dokumentat e lëshuara nga vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka marrëveshje dy palëshe për këtë çështje. Lista është e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

PROCEDURAT E NJOHJES DHE NJËSIMIT

Procedura e njohjes dhe njësimit, pas aplikimit online, e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga e strukturës përkatëse të QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 30 ditëve kalendarike.

Përrjashtimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma të fituara në vendet e BE dhe SHBA, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi në rast se diploma dhe suplementi i saj janë të pajisura me vulë apostile. Në rastet kur QSHA evidenton parregullsi në aplikim lidhur për dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të dokumentacionit sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacionin e depozituar, QSHA-ja me anë të postës elektronike, ose sistemit i kërkon aplikantit plotësimin e dokumentacionit brenda 5 ditëve nga dita që është bërë aplikimi. Në rast të mos paraqitjes së dokumentacionit, brenda 30 ditëve, QSHA-ja ndërpret shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni përkatës arkivohet. Akti administrativ i arkivimit i njoftohet aplikuesit nëpërmjet portalit e-albania. Në rastet kur dosja është arkivuar për shkak të mosplotësimin të dokumentacionit, aplikuesi bën aplikim të ri sipas kriterëve të cituara në këtë udhëzim duke bërë një pagesë të re në favor të QSHA.

NJOHJA E DIPLOMAVE TË PERSONAVE QË KANË STATUSIN E REFUGJATIT, PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE PERSONAVE TË NGJASHËM ME REFUGJATËT

1. Për personat që kanë statusin e refugjatit, personit të zhvendosur dhe/ose personit të ngjashëm me refugjatin nuk zbatohen procedurat e parashikuara në Kreun II të këtij udhëzimi.
2. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve, përveç gradës shkencore “Doktor”, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
 - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

- ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
 - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët;
3. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor”, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
 - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
 - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.
4. Aplikimi për njohjen dhe njësimin e titujve akademik, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a. formulari i aplikimit plotësohet në QSHA, sipas shtojcës nr. 1;
 - b. aplikanti dorëzon në QSHA dokumentacionin e mëposhtëm:
 - i. diplomën/certifikatën profesionale, diplomën ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - ii. suplementin e diplomës dhe/ose listën e notave, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.
 - iii. fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës, ose dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet identiteti i tij;
 - iv. dokumentin e lëshuar nga organet kompetente me anë të të cilit vërtetohet që personi ka fituar statusin e refugjatit, person i zhvendosur dhe person i ngjashëm me refugjatët.
5. Refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, të cilët paraqesin dokumentacion të pjesshëm, ose nuk mund të paraqesin dokumente për të vërtetuar kualifikimet e tyre dhe/ose periudhat e studimit, kanë të drejtën e njohjes dhe njësimit pa

pagesë dhe brenda një afati të arsyeshëm të kualifikimit të tyre dhe/ose periudhave të studimit me qëllim për të vazhduar studimet e mëtejshme, ose për tu punësuar.

Afatet e përfundimit të shërbimit:

Procedura e njohjes dhe njësimit, pas aplikimit online, e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore “Doktor”, të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga e strukturës përkatëse të QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 30 ditëve kalendarike.

Përrjashtimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma të fituara në vendet e BE dhe SHBA, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi në rast se diploma dhe suplementi i saj janë të pajisura me vulë apostile. Në rastet kur QSHA evidenton parregullsi në aplikim lidhur për dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të dokumentacionit sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

TARIFAT.

Pagesa për njohjen dhe njësimin e certifikatave/diplomave dhe gradave shkencore, që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, si dhe titujve akademikë përveç aplikimeve të paraqitura nga refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, është 2000 (dy mijë) lekë dhe kryhet në llogarinë bankare të QSHA, të përcaktuar në faqen zyrtare të QSHA dhe e-Albania, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave.

Pagesa mund të bëhet on line gjatë kryerjes së aplikimit nëpërmjet kartës së kreditit/debitit.

Për refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët, shërbimi ofrohet pa pagesë.